



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.145 dt.23.10.1998

**PER REZULTATET E KONTROLLIT EKONOMIKO FINANCIAR
TE KRYER NE TEATRIN E KUKULLAVE TIRANE.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.23.10.1998, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës për rezultatet e kontrollit të kryer në Teatrin e Kukullave Tiranë dhe vëren se : Puna e kryer për ruajtjen, dokumentimin, administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, dhënien e objekteve me qera, blerjet e mjeteve kryesore, ka patur të meta e dobësi si dhe veprime që bien në kundërshtim përkatësisht me ligjin Nr.6942, dt.25.12.1984, VKM Nr.70, dt.11.03.1985 ndryshuar me VKM Nr.170, dt.03.04.1993, VKM Nr.781, dt.11.11.1996 “Për dhënien me qera”, VKM Nr.478, dt.07.11.1992 “Për përdorimin e të ardhurave dytësore” si dhe ligjin Nr.7971, dt.26.07.1995 “Për prokurimin publik”.

Në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I

1. Në mbështetje të ligjit Nr.7526, dt.03.12.1991 pika.b dhe pika.d “Për marrdhëniet e punës”, të largohet nga detyra Drejtori i Teatrit të Kukullave Gjik Kurtiqi për shkelje financiare dhe veprimeve që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI